	Komuna Vitisë **Shmlm „Kongresi i Manastirit“ Pozheran**	

Duke u mbështetur te **neni 11** paragrafi 1 nënparagrafi 2.13,Shtojca 2 të Udhëzimit Administrativ **Nr.02/2016** për aktivitet jashtëshkollore të datës **12.01.2016(MASHTI)**,Statutit të shkollës lidhur meVendimin e Këshillit Drejtues të Shkolles,drejtoria **SHMLM „Kongresi i Manastirit“** në Pozheran në bazë të kompetencave dhe autorizimeve shpallë:

REPUBLIKA E KOSOVË
KOMUNA E VITISË
Shkolla e Mesme e Lartë „KONGRESI I MANAS
Nr. 331/26 Data: 15.10.2026
POZHERAN

FTESË PËR OFERTË

Për organizimin e ekskursionit të maturantëve të SHMLM-së „Kongresi i Manastirit” në Pozheran

SHMLM-ja „Kongresi i Manastirit” në Pozheran fton të gjitha agjencitë turistike të interesuara që të paraqesin ofertat e tyre për organizimin e ekskursionit të maturantëve të shkollës.

1. Të dhënat e përgjithshme për ekskursionin

- **Destinacioni:** Republika e Shqipërisë.
- **Kohëzgjatja:** 4 ditë dhe 3 net.
- **Periudha e realizimit:** Nga data 25.10.2026 deri më 28.10.2026.
- **Numri i pjesëmarrësve:** Rreth 50 nxënës (maturantë) dhe 4 kujdestarë të klasave, të cilët do të kujdesen për nxënësit gjatë gjithë ekskursionit.

Në ofertë duhet të paraqitet çmimi i përgjithshëm për një nxënës, duke përfshirë transportin, dhe shpenzimet e tjera të parashikuara për realizimin e ekskursionit, përfshirë hyrjet në muze, kala dhe objekte të tjera që do të vizitohen, sipas planit të miratuar nga Këshilli Drejtues dhe Drejtoria e Shkollës.

2. Kushtet dhe dokumentacioni i nevojshëm për konkurrim

Agjencitë turistike që konkurrojnë duhet t’i plotësojnë këto kushte dhe të dorëzojnë dokumentacionin përkatës:

1. Agjencia turistike duhet të jetë e licencuar, të posedojë numër të mjaftueshëm autobusësh komodë dhe me klimë, si dhe të dëshmojë se autobusët i kanë kryer kontrollet teknike sipas procedurave ligjore në fuqi.

2. Agjencia duhet të paraqesë dëshmi për gjendjen e mirë shëndetësore fizike dhe mendore të shoferëve të autobusëve.

3. Certifikatat shëndetësore të shoferëve nuk duhet të jenë më të vjetra se gjashtë (6) muaj.

4. Agjencia duhet të sigurojë përkujdesje mjekësore për nxënësit gjatë gjithë ekskursionit dhe të paraqesë dokumentacionin përkatës të mjekut, përfshirë dëshminë e punësimit dhe diplomën përkatëse.

5. Agjencia duhet të sigurojë një automjet përcjellës gjatë gjithë udhëtimit.

6. Autobusët që do të përdoren për ekskursion duhet të kenë kontrollin teknik të kryer dhe të jenë në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

7. Agjencia duhet të posedojë certifikatën përkatëse për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar të udhëtarëve.

3. Programi i vizitave gjatë ekskursionit

Gjatë katër (4) ditëve të ekskursionit parashihen këto vizita:

1. **Lezhë – Durrës:** Vizitë te varri i Gjergj Kastriotit – Skënderbeut në Lezhë dhe në Amfiteatrin Antik të Durrësit.

2. **Fushë-Krujë:** Vizitë në Muzeun Kombëtar Gjergj Kastrioti – Skënderbeu.

3. **Fier – Vlorë:** Vizitë në qytetin antik të Apolonisë dhe në Shtëpinë e Pavarësisë në Vlorë.

4. **Tiranë:** Vizitë në Teatrin Kombëtar, në muzeun ose objektin e paraparë në ish-rezidencën e Enver Hoxhës, në Sheshin Skënderbej dhe në stadiumin e kryeqytetit.

4. Afati dhe mënyra e dorëzimit të ofertave

1. Afati për konkurrim është shtatë (7) ditë nga dita e publikimit të këtij njoftimi në faqen zyrtare të Shkollës dhe të Komunës.

2. Ofertat e dorëzuara pas afatit të përcaktuar nuk do të pranohen.

3. Ofertat me dokumentacion jo të plotë nuk do të shqyrtohen.

4. Dokumentacioni duhet të dorëzohet nga data 15.10.2026 deri më 21.10.2026, në orën 14:00, në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA).

5. Hapja e ofertave do të bëhet më datë 21.10.2026, në orën 14:30, në ambientet e SHMLM-së „Kongresi i Manastirit" në Pozheran.

Me date:15.10.2026

Drejtoria e Shkollës

Mufail Halabaku